

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE  
NR. 4437 REP  
NR. 1768 KOL



KONTRATE SHIT-BLERJE

(kuotash kapitali te shoqerise "UNIVERSITETI PEDAGOGJIK I TIRANES" shpk)

Sot, me date 27 .07.2009 (dymije e nente) para meje noterit MIMOZA SADUSHAJ, anetar i Dhomes Notereve Tirane, ne adresen: Rruga "Vaso Pasha" nr.13, u paraqiten personalisht palet e meposhtme:

**PALA SHITSE:**

Arben NGRACANI i biri Isufit, i dtl. 12.07.1969, banues ne Berat ne adresen: Rruga "30 Dhjetori", pallati 6 katesh prane Deges Ushtarake, kati 5, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes nr. Z1097922, ortak i vetem i shoqerise Shoqeria "UNIVERSITETI PEDAGOGJIK I TIRANES" (U.P.T) shpk, person juridik, regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me nr. NIPT-i K91825004S,  
Qe me poshte do te quhet Shitesi

**PALA BLERESE:**

- Musa KRAJA, i biri Abdullait, i dtl. 03.10.1938 lindur dhe banues ne Tirane ne adresen: Rruga "Myslym Shyri", Pall. 53, Nr. 16, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i panjohur me pare personalisht prej meje, identifikuar ne baze te pasaportes nr. Z1389511,
- Miti KOÇI, i biri Themiu, i dtl. 10.10.1946 lindur dhe banues ne Tirane ne adresen: Rruga "Naim Frasheri" Pall. 4, Shk. 1, Nr. 6, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i panjohur me pare personalisht prej meje, identifikuar ne baze te pasaportes nr. Z1660975,  
Qe me poshte do te quhen Bleresit

**BAZA LIGJORE:**

Neni 73 i ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Une, noteri, pasi u binda per identitetin e paleve dhe aftesine e tyre per te vepruar, te cilet jashte kesaj zyre kane rene dakort ne parim per shitjen e 25% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise, vendosa te perpiloj kete kontrate shit-blerje kuotash sipas kushteve sa me poshte vijon:

### Neni 1

(Objekti)

Objekti i kesaj kontrate eshte shitja e 25% nga (100%) te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise "UNIVERSITETI PEDAGOGJIK I TIRANES" (U.P.T) shpk qe zoteron Shitesi, ne favor te Bleresve ne raportet dhe vleren e rene dakort midis paleve.

### Neni 2

(Vlefshmeria e shitblerjes)

Shitesi ka rene dakort te shese nje pjese te kuotave qe zoteron ne shoqerine "UNIVERSITETI PEDAGOGJIK I TIRANES" (U.P.T) shpk, tek Bleresit dhe kjo shitje behet ne perputhje me nenet 15, 21 te statutit te shoqerise dhe nenin 73 te ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

### Neni 3

(Pershkrimi)

Shoqeria "UNIVERSITETI PEDAGOGJIK I TIRANES" (U.P.T) shpk, eshte themeluar ne perputhje me legjislacionin tregtar shqiptar dhe eshte regjistruar si person juridik ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me dt. 25.06.2009 me nr. NIPT-i K91825004S.

Shitesi eshte ortak i vetem i kesaj shoqerie e cila ka nje kapital themeltar prej 1.000 000 leke, i ndare ne 100 kuota me vlere nominative 10.000 leke secila.

Shoqeria ka si objekt veprimtarie administrimin e drejtimin didaktik te institucionit arsimor te larte, jo publik, universitar dhe pasunivesitar etj ndaj Bleresit, personalitete te njohur ne kete fushe kane shfaqur interes dhe kane rene dakort me Shitesin per blerjen e nje pjese te kuotave te shoqerise sipas objektit te kesaj kontrate.

Shoqeria deri me sot nuk ka realizuar ndonje vendimarrje apo te kete depozituar ne regjister tregtar per ndryshime ne vleren e kapitalit themetar si dhe te kuotave te tij.

### Neni 4

(Çmimi dhe menyra e likuidimit)

Shitesi i shet Bleresve, 25% nga (100%) te kuotave te kapitalit themeltar qe zoteron ne shoqeri, me çmimin prej 250.000 (dyqind e pesedhjete mije) leke qe perfaqeson kontributin e dhene prej tij ne formimin e kapitalit themeltar te shoqerise.

Shitblerja e kuotave objekt kontrate realizohet ne raporte te barabarta per Bleresit te cilet perfitojne nga 12.5% te kuotave te kapitalit te shoqerise secili, kundrejt çmimit te mesiperm i cili shlyhet po ne keto raporte prej tyre, pra nga 125.000 (njqind e njezet e pese mije) leke per secilin.

Shitesi deklaroi se çmimi kontraktor eshte likuiduar nga Bleresit me para ne dore (Cash) jashte kesaj zyre.





Neni 5

(Te drejtat dhe detyrimet e shitesit)

Shitesi garanton Bleresit se keto kuota jane lirisht te transferueshme dhe te lira nga çdo barre ne perputhje me aktet e shoqerise dhe ligjin tregtar.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, Shitesi humbet te gjitha te drejtat qe rrjedhin nga pronesia e 25% te kuotave kapitalit themeltar por mbetet ortak maxhoritar i shoqerise me 75% te kuotave te kapitalit te saj qe nuk jane objekt disponimi.

Neni 6

(Te drejtat dhe detyrimet e bleresave)

Bleresit qe nga ky moment, fitojne te gjitha te drejtat qe rrjedhin nga pronesia e kuotave te kapitalit objekt i kesaj kontrate dhe behen ortake te shoqerise me 25% te kapitalit te saj (nga 12.5% te kapitalit secili) duke marre persiper ne nje njeften kohe dhe detyrimet qe rrjedhin nga kuotat e blera.

Neni 7

(Mosmarreveshjet)

Mosmarreveshjet qe lindin nga kjo kontrate do te zgjidhen me mirekuptim nga palet duke u nisur nga besimi i mire, ne rast te kundert kompetente eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 8

Hyrja ne fuqi

Kontrata hyn ne fuqi duke sjelle te gjitha efektet per palet daten e nenshkrimit, ndersa per te tretet ne momentin e regjistrimit te praktikës perkatese ne Regjistrin Tregtar.

Neni 9

Te ndryshme

Kjo kontrate eshte hartuar ne gjuhen shqipe ne 5 (pese) ekzemplare origjinale me nga tre faqe secili, nje per palen shitesë, nje mbahet nga noteri, nje per tu depozituar ne Regjistrin Tregtar dhe nga nje ekzemplar per secilin bleres.

Palet pasi konfirmuan vullnetin e tyre duke lexuar e pranuar kushtet e mesiperme, e nenshkruajne ate rregullisht para meje. Une noteri e vertetoj sipas ligjit.

SHITESI

Arben NGRAÇANI

*Arben Ngraçani*

BLERESIT

Musa KRAJA

*Musa Kraja*

Miti KOÇI

*Miti Koci*

NOTERI



*[Handwritten signatures of the notary and other parties]*